



Ngjarjet e Mëvonshme në Mjedisin Aktual - Konsideratat e Auditimit për Ndikimin e COVID – 19

Ky material është përgatitur për të theksuar fushat kryesore ku duhet të fokusohemi në mjedisin aktual kur ndërmerren procedura në lidhje me ngjarjet e mëvonshme, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit™ (SNA™).

Ky material nuk ndryshon ose anashkalon SNA-të, tekstet e të cilave janë detyruese. Leximi i këtij materiali nuk zëvendëson leximin e SNA-ve.

Hartuesit, personat e ngarkuar me qeverisjen dhe përdoruesit e pasqyrave financiare mund ta konsiderojnë këtë material të dobishëm për të kuptuar përgjegjësitë e audituesit në lidhje me ngjarjet e mëvonshme.

Pasiguria dhe sfidat e shkaktuara nga pandemia e COVID-19, përfshirë mundësinë e ngjarjeve të paplanifikuara që ndodhin në çdo kohë, kohëzgjatjen e pasigurtë të këtij mjedisi aktual dhe ndryshimet në afatet kohore ndikojnë në shumë fusha brenda auditimit. Në fund të çdo periudhe raportimi, entitetet do të vlerësojnë me kujdes informacionin i cili bëhet i disponueshëm pas datës së raportimit, por përpara publikimit të pasqyrave financiare. Prandaj, audituesve ka të ngjarë t'ju kërkohej një fokusim më i madh në ngjarjet që ndodhin midis datës së pasqyrave financiare dhe datës së raportit të audituesit (d.m.th., ngjarjet e mëvonshme¹) dhe në efektet e tyre, nëse ka, në pasqyrat financiare të entitetit (shikoni edhe Përkufizimet Përkatëse dhe Përshkrimet në faqen e fundit për kontekst shtesë).

Cilat janë ngjarjet e mëvonshme dhe si duhet të reflektohen ato në pasqyrat financiare?

SNA 560, *Ngjarjet e Mëvonshme*, përcakton përgjegjësitë e audituesit në lidhje me ngjarjet e mëvonshme. Në përgjithësi ekzistojnë dy lloje të **ngjarjeve të mëvonshme**:

- a) *Ato ngjarje që japin evidencë të kushteve që kanë ekzistuar në datën e pasqyrave financiare*
- b) *Ato ngjarje që japin evidencë të kushteve që kanë lindur pas datës së pasqyrave financiare.*²

Siç përkruhet në SNA 560, shumë kuadro të raportimit financiar ju referohen ngjarjeve që ndodhin pas datës së pasqyrave financiare si ngjarje të mëvonshme. Për shembull, Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit (SNK) 10, *Ngjarjet pas Periudhës së Raportimit*, tregon trajtimin në pasqyrat financiare të transaksioneve dhe ngjarjeve që ndodhin midis datës së pasqyrave financiare dhe datës kur pasqyrat financiare miratohen për publikim.

¹SNA 560, *Ngjarjet e Mëvonshme*, paragrafi 5 (e)


²SNA 560, paragrafi 2

Drejtimi është përgjegjës për të bërë rregullimet ose për të përgatitur shënimet e tjera shpjeguese përkatëse në pasqyrat financiare, sipas rastit, në lidhje me ngjarjet e mëvonshme, në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi. Përkufizimet e mëposhtme dhe trajtimi që rezulton nga pasqyrat financiare janë përshkruar në SNK 10.³

Lojet e ngjarjeve të mëvonshme	Përkufizimi dhe ndikimi
Ngjarjet që kërkojnë rregullim në PF	Ngjarjet që japin evidencë të kushteve që ekzistojnë në fund të periudhës së raportimit (d.m.th., në datën e pasqyrave financiare). Ndikimi: Rregullohen (korrigjohen) shumat e njohura në pasqyrat financiare.
Ngjarjet që nuk kërkojnë rregullim në PF	Ngjarjet që tregojnë për kushtet që kanë lindur pas periudhës së raportimit (d.m.th., pas datës së pasqyrave financiare). Ndikimi: Jepen informacione në shënimet shpjeguese për natyrën e ngjarjes dhe një çmuarje të efektit financiar të saj ose një deklaratë që një çmuarje e tillë nuk mund të bëhet.

Konsideratat e Drejtimit kur Vlerësohen Ngjarjet pas Datës së Pasqyrave Financiare

Në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar, drejtimi ushtron gjykimin për përcaktimin e ndikimit në pasqyrat financiare të çdo ngjarje të mëvonshme që lidhet me pandeminë e COVID-19, duke marrë parasysh datën e pasqyrave financiare, faktet dhe rrethanat e entitetit dhe kushtet që ekzistojnë në atë datë, ose që kanë lindur pas kësaj date. Konsideroni, për shembull, skenarin ilustrues të mëposhtëm:



*Organizata Botërore e Shëndetësisë

Në këtë skenar, data e pasqyrave financiare është përpara deklaratës së OBSH-së për një gjendje emergjence të shëndetit publik, deklaratës të OBSH-së për pandeminë dhe që rezultoi në rënien e performancës së tregjeve globale, por pas rasteve të para të raportuara në Wuhan, Kinë. Në përcaktimin nëse ekzistojnë kushte përkatëse në datën e pasqyrave financiare, drejtimi duhet të marrë parasysh rrethanat e tyre të veçanta, për shembull, vendndodhjen e tyre dhe vendndodhjen e operacioneve të tyre (p.sh., nëse kompania kryente operacione të rëndësishme në Kinë).

³SNA 10, paragrafët 3, 8 dhe 10

Konsideratat e veçanta do të zbatoheshin nëse data e pasqyrave financiare do të ishte 31 Mars 2020 ose 30 Qershor 2020. Ndërsa ndikimet e përhapjes së COVID-19 vazhdojnë të evoluojnë, përfshirja e ngjarjeve që lidhen posaçërisht me kushtet që ekzistojnë ose ekzistojnë në datën e pasqyrave financiare, ose pas datës së raportimit, do të kërkojë vlerësim të kujdesshëm.

Udhëzime të mëtejshme në lidhje me përgjegjësitë e drejtimit për ngjarjet e mëvonshme në mjedisin aktual mund të gjenden në artikullin e Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (IFAC) "Ndikimet në Raportimin Financiar nga COVID-19".⁴ Disa vende gjithashtu kanë nxjerrë udhëzime për rrethanat specifike lokale që lidhen me faktin nëse ngjarjet që lindin nga pandemia COVID-19 janë ngjarje që kërkojnë rregullim ose që nuk kërkojnë rregullim (të shpjegueshme), të cilat gjithashtu mund të jenë të dobishme edhe për të tjerët.

Si ndikohen përgjegjësitë e audituesit nga pandemia e COVID-19 në lidhje me sigurimin e evidencës së përshtatshme të auditimit rreth ngjarjeve të mëvonshme?

Audituesve ju kërkohet të kryejnë procedura të që kanë për qëllim të sigurohet evidencë auditimi e mjaftueshme dhe e përshtatshme për faktin që të gjitha ngjarjet që kërkojnë rregullimin, ose ngjarjet që ndodhin midis datës së pasqyrave financiare dhe raportit të audituesit, të cilat kërkojnë dhënie e informacioneve në shënime shpjeguese në pasqyrat financiare, janë identifikuar dhe paraqitur në mënyrën e duhur në pasqyrën financiare në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar (shiko SNA 560, paragrafët 6–8).

Gjatë marrjes përsipër të punës për t'iu përgjigjur vlerësimit të rrezikut të audituesit që lidhet me ngjarjet e mëvonshme, duke përfshirë arsyet që lidhen me ndikimin e pandemisë COVID-19, audituesi merr në konsideratë rregullimet ose dhëniet e shënimeve shpjeguese të drejtimit, duke përfshirë afatet e përdorura për të bërë dallimin midis ngjarjeve rregulluese dhe jo-rregulluese. Gjithashtu, kjo përfshin ndikimin e ndryshimeve në mjedis në njohjen dhe matjen e tepricave të llogarive dhe transaksioneve në pasqyrat financiare (nëse rregullohen), ose shënime të tjera shpjeguese (nëse nuk rregullohen).

Kryerja e Procedurave deri në datën e Raportit të Audituesit

Në disa vende, është vendosur një zgjatje e kohës për paraqitjen e raporteve financiare. Në këto rrethana, ndërsa audituesit mund të kenë kryer tashmë procedura të ngjarjeve të mëvonshme përtej datës së raportit të audituesit të planifikuar fillimisht, audituesve do t'u kërkohet të ndërmarrin procedura për të mbuluar periudhën më të gjatë. E krahas me ndryshimin e mjedisit aktual, është e rëndësishme që evidenca e auditimit të marrë në lidhje me ngjarjet e mëvonshme të mbulojë të gjithë periudhën deri në datën e raportit të audituesit. Për shembull, në skenarin ilustrues të paraqitur më sipër, procedurat e auditimit për ngjarjet e mëvonshme duhet të shtrihen deri më 31 Mars 2020.

Shembuj të ngjarjeve dhe kushteve që mund të jenë të rëndësishme në mjedisin aktual

Më poshtë janë dhënë shembuj të ngjarjeve ose kushteve që mund të ndikohen nga, ose ekzistojnë si rezultat i pandemisë COVID-19, dhe të cilat mund të jenë të rëndësishme për audituesin për të përcaktuar nëse ngjarjet e mëvonshme kanë ndodhur dhe, nëse është e zbatueshme, kanë qenë të reflektuara në mënyrën e duhur në pasqyrat financiare (gjithashtu shiko SNA 560, paragrafët A7 – A10):

⁴<https://www.ifac.org/knowledge-gateway/supporting-international-standards/discussion/financial-reporting-implications-covid-19>

Publikim nga Stafi i Praktikave të Auditimit - Ngjarjet e Mëvonshme



Angazhimet, huatë dhe garancitë e reja që kanë lindur si rezultat i pandemisë



Blerjet ose shitjet e aktiveve të ndodhura së fundmi ose të planifikuara si rezultat i pandemisë



Rritjet e kapitalit ose emetimi i instrumentave të borxhit, të tilla si emetimi i aksioneve apo obligacioneve të reja, ose një marrëveshje për bashkim apo për likuidim që është bërë apo planifikuar



Probabiliteti i plotësimit të kushteve të kushtëzimit të performancës në bazë të marrëveshjeve të pagesës së bazuar në aksione dhe llogaritet e duhura për modifikimet ose shlyerjet e marrëveshjeve të tilla



Pagesat për ndihmë ose stimul ekonomik të dhëna nga qeveria në formën e huave ose granteve



Çdo zhvillim që lidhet me ngjarjet e kushtëzuara (për shembull, detyrimet e reja të kushtëzuara ose rrethanat që ndikojnë në vlerësimin e detyrimeve të kushtëzuara, mundësia për të përmbushur objektivat e performancës të dakordësuara për shumën e kushtëzuar në marrëveshjet e kombinimit të biznesit, etj)



Rregullimet kontabël të pazakonta që janë bërë ose janë kundërshtuar, të tilla si regjistrimet e mbylljes shtesë ose të rishikuara, ose ngjarjet që kërkojnë regjistrime jo standarde në ditar



Ngjarjet që vënë në dyshim përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura në pasqyrat financiare (p.sh. ngjarjet që vënë në dyshim vlefshmërinë e supozimit të vijmësisë)



Ngjarjet që janë të rëndësishme për matjen e vlerësimeve ose provizioneve të bëra në pasqyrat financiare. Shembujt përfshijnë shuma derivative dhe mbrojtëse (p.sh. kur një transaksion i parashikuar nuk është më i mundshëm), kërkesat e sigurimit (p.sh. nëse është pothuajse e sigurtë që shumat janë të arkëtueshme gjatë ndërprerjes së biznesit dhe / ose sigurimet e tjera dhe dhënit e shënimeve shpjeguese të mundshme të aktiveve të kushtëzuara), marrëveshjet me zbritje me klientët ose furnitorët, shumat e ndryshueshme, komisionet sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, etj)



Ngjarjet që janë të rëndësishme për rikuperimin e aktiveve



Modifikimi i marrëveshjeve kontraktuale ekzistuese (p.sh. zvogëlimi ose shtyrja e pagesave të qirasë së dhënë nga një airadhënës te airamarrësi. modifikime të kushteve të borxhit. etj)



Shumat e tatimit (p.sh. ndikimi i fluksit të reduktuar të të mirave dhe shërbimeve në marrëveshjet e transferimit të çmimeve; rikuperueshmëria e aktiveve tatimore të shtyra)



Përfitimet nga ndërprerja e marrëdhënieve të punës që lindin nga një reduktim i fuqisë punëtore (p.sh. si rezultat i mbylljes ose riorganizimit të operacioneve që kanë ndodhur pas datës së raportimit)

Ushtrimi i skepticizmit profesional

Përcaktimi dhe trajtimi i menaxhimit të ngjarjeve rregulluese ose jo-rregulluese, siç është e zbatueshme, ka mundësi të jetë më sfiduese për shkak të ndikimit të COVID-19. Përkatësisht, mund të ketë nevojë që audituesi të hartojë dhe të kryejë procedura të zgjeruara ose shtesë.

Pasiguritë dhe sfidat që lidhen me COVID-19, duke marrë parasysh faktet dhe rrethanat e entitetit, ka më shumë mundësi të rezultojnë në gjykime të rëndësishme të drejtimit, duke kërkuar gjykime të rëndësishme të auditimit, gjë që kërkon që audituesi të ushtrojë skepticizmin profesional në kryerjen e

punës për ngjarjet e mëvonshme. Zbatimi i skepticizmit profesional në këtë drejtim nënkupton marrjen në pyetje dhe konsiderimin e mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë së evidencës së auditimit që të gjitha ngjarjet materiale të mëvonshme (p.sh., ato që kërkojnë rregullim ose dhënie të shënimeve shpjeguese në pasqyrat financiare) janë identifikuar dhe janë paraqitur në mënyrë të përshtatshme në pasqyrat financiare në varësi të rrethanave.

Deklarimet me shkrim

Audituesit i kërkohet nga SNA 560, paragrafi 9, të kërkojë një deklarament me shkrim që të gjitha ngjarjet e ndodhura pas datës së pasqyrave financiare, dhe për të cilat kuadri i zbatueshëm i raportimit financiar kërkon rregullim ose dhënie të shënimeve shpjeguese, janë rregulluar ose janë paraqitur në shënimeve shpjeguese.

Deklarimet me shkrim kërkohen të datohen sa më afër datës së raportit të audituesit, por jo pas kësaj date.⁵ Pandemia e COVID-19 mund të jetë një faktor ndikues për vonesën në miratimin e pasqyrave financiare (siç u pohua edhe më sipër, disa vende kanë lejuar kohë shtesë ose zgjatje të kohës për paraqitjen e raporteve financiare). Në raste të tilla është e rëndësishme që deklaramentet me shkrim të mbulojnë periudhën shtesë deri në datën e raportit të audituesit, ose sa më afër të jetë e mundur, duke përfshirë edhe ndryshimet e mëtejshme që mund të jenë të nevojshme të përfshihen.

Gjithashtu, nëse drejtimi ka ndërmarrë punën e tij në lidhje me identifikimin dhe llogaritjen e ngjarjeve rregulluese dhe jo-rregulluese, siç është e zbatueshme, për një periudhë kohore që përfundon më herët sesa periudha e zgjatur, audituesi mund të kërkojë nga drejtimi që të zgjerojë konsideratat e tij në varësi të çdo ndryshimi gjatë periudhës së zgjatur.

Rëndësia e komunikimit me personat e ngarkuar me qeverisjen

Pandemia e COVID-19 ka rezultuar sfiduese dhe komplekse në fusha të ndryshme që lidhen me raportimin financiar. Personat e ngarkuar me qeverisjen do të kenë përgjegjësi gjithnjë e më të rëndësishme në raportimin financiar të entitetit dhe proceset e tjera të qeverisjes. Për shembull, ata mund të kenë nevojë të sigurohen që entiteti përshtat hartimin dhe mirëmbajtjen e kontrolleve të duhura në lidhje me besueshmërinë e raportimit financiar, efektivitetin dhe eficiencën e operacioneve dhe pajtueshmërinë me rregulloret dhe ligjet në fuqi.

Komunikimi i vazhdueshëm dhe i rregullt i audituesit me personat e ngarkuar me qeverisjen, veçanërisht në periudhën para datës së ndërtimit të pasqyrave financiare, mund të ndihmojë me njohuritë që audituesi ka për entitetin mbi ndryshimet e bëra për t'iu përgjigjur mjedisit në zhvillim dhe mund t'i ndihmojë audituesit në vlerësimin se cilat procedura duhet të ndjekin ata për të grumbulluar evidencë të përshtatshme dhe të mjaftueshme.

A ka procedura të kërkuara auditimi nëse ngjarjet nga pandemia e COVID-19 bëhen të njohura për audituesin pas datës së raportit të audituesit?

Audituesi nuk ka asnjë detyrim të kryejë ndonjë procedurë auditimi në lidhje me pasqyrat financiare pas datës së raportit të audituesit (edhe para ose pas datës së publikimit të pasqyrave financiare), përveçse nëse një fakt bëhet i njohur për audituesin që, nëse ai do të ishte njohur në datën e raportit të audituesit, mund të kishte bërë që audituesi ta ndryshonte raportin e tij.

Për shembull, në skenarin ilustrues të paraqitur më sipër, nëse ngjarjet e rëndësishme të COVID-19 u bënë të njohura për audituesin më 8 Prill 2020, që ishin të njohura më 31 Mars 2020 (data e raportit të

⁵SNA 580, *Deklarimet me Shkrim*, paragrafi 14

audituesit), kjo mund të kishte rezultuar me një ndryshim në raportin e audituesit prandaj mund të kërkohen procedura shtesë.

SNA 560, paragrafët 10 deri te 17, adreson përgjegjësitë e audituesit kur faktet bëhen të njohura për audituesin pas datës së raportit të audituesit.

Si ndikojnë rezultatet e procedurave të audituesit nga ngjarjet e mëvonshme në raportin e audituesit?

Nëse, bazuar në rezultatet e procedurave të kryera të auditimit, audituesi përcakton që pasqyrat financiare kanë anomali materiale ose nuk është në gjendje të sigurojë evidencë auditimi të nevojshme dhe të mjaftueshme për të përcaktuar nëse pasqyrat financiare kanë anomali materiale, një modifikim i mendimit në raportin e audituesit kërkohet në përputhje me SNA 705 (i rishikuar).⁶

Nëse audituesi është në gjendje të sigurojë evidencëtë mjaftueshme dhe të përshtatshme auditimi në lidhje me ngjarjet e mëvonshme siç kërkohet në kushtet e SNA 560, ai mund ose nuk mund ta konsiderojë të përshtatshme identifikimin e ngjarjes së mëvonshme si një Çështje Kryesore Auditimi sipas SNA 701,⁷ ose ai mund ose nuk mund të përcaktojë se është e nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve për ngjarjen e mëvonshme përmes përfshirjes së një Paragrafi që Thekson Çështjen ose të një Paragrafi për Çështje të Tjera në përputhje me SNA 706.⁸ Raportimi i audituesit është adresuar më së shumti në një Publikim nga Stafi i Praktikave të Auditimit: *Raportimi i audituesit në mjedisin aktual-Konsideratat e Auditimit për shkak të ndikimit të COVID-19.*⁹

Përkufizimet dhe përshkrimet përkatëse¹⁰

Datat e ndryshme janë referuar gjatë këtij publikimi. Përkufizimet ose përshkrimet që ndihmojnë në të kuptuarit e kontekstit janë dhënë më poshtë:

- **Data e pasqyrave financiare**— Data e mbylljes së periudhës më të fundit të mbuluar nga pasqyrat financiare.
- **Data e miratimit të pasqyrave financiare**— Data në të cilën të gjitha pasqyrat që përbëjnë pasqyrat financiare, përfshirë shënimet përkatëse, janë përgatitur dhe organet që kanë autoritetin përkatës pohojnë se kanë marrë përgjegjësinë për këto pasqyra financiare.
- **Data e raportit të audituesit**— Data që audituesi daton raportin e tij mbi pasqyrat financiare. Kjo datë informon përdoruesit e këtij raporti që audituesi ka marrë në konsideratë efektet e ngjarjeve dhe transaksioneve, për të cilat audituesi është vënë në dijeni dhe që kanë ndodhur deri në atë datë.¹¹
- **Data e publikimit të pasqyrave financiare**— Data në të cilin raporti i audituesit dhe pasqyrat financiare të audituara janë të disponueshme për palët e treta.

⁶SNA 705 (irishikuar), *Modifikimet e Opinionit në Raportin e Audituesit të Pavarur*, paragrafi 6

⁷SNA 701 *Komunikimi i Çështjeve Kryesore të Auditimit në Raportin e Audituesit të Pavarur*, paragrafi 9-10

⁸SNA 706 (irishikuar), *Paragrafët që Theksojnë Çështjen dhe Paragrafët për Çështje të tjera në Raportin e Audituesit të Pavarur*, paragrafi 8-11

⁹Do të publikohet në May 2020

¹⁰ SNA 560, paragrafi 5 (a)-(d)

¹¹SNA 700 (irishikuar), *Formimi i një opinionit dhe raportimi mbi Pasqyrat Financiare*, paragrafi A66

Strukturat dhe proceset që mbështesin operacionet e IAASB lehtësohen nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve[®] ose IFAC[®].

IAASB dhe IFAC nuk e pranojnë përgjegjësinë për humbjen e shkaktuar ndaj ndonjë personi që vepron ose nuk i përmbahet veprimit në përputhje me materialin në këtë publikim, qoftë kjo një humbje e shkaktuar nga pakujdesia ose jo.

Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, Standardet Ndërkombëtare të Angazhimeve të Sigurisë, Standardet Ndërkombëtare të Angazhimeve të Rishikimit, Standardet Ndërkombëtare në Shërbimet e Lidhura, Standardet Ndërkombëtare të Kontrollit të Cilësisë, Shënimet e Praktikës së Auditimit Ndërkombëtar, Draftet e Publikuara, Letrat e Konsultimit dhe publikime të tjera të IAASB-së janë publikuar nga, dhe të drejtat e autorit të, IFAC.

Të drejtat e autorit © Maj 2020 nga IFAC. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Ky publikim mund të shkarkohet për qëllime personale dhe jo-tregtare (p.sh., kërkimi ose referenca profesionale) nga www.iaasb.org. Leja me shkrim kërkohet për të përkthyer, riprodhuar, ruajtur, transmetuar ose për të përdorur në mënyra të ngjashme këtë dokument.

“Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Auditimit dhe Sigurisë”, “Standardet Ndërkombëtare të Auditimit”, “Standardet Ndërkombëtare të Angazhimeve të Sigurisë”, “Standardet Ndërkombëtare të Angazhimeve të Rishikimit”, “Standardet Ndërkombëtare në Shërbimet e Lidhura”, “Standardet Ndërkombëtare të Kontrollit të Cilësisë”, “Shënimet e Praktikës së Auditimit Ndërkombëtar”, “IAASB”, “ISA”, “ISAE”, “ISRE”, “ISRS”, “ISQC”, “IAPN” dhe logoja e IAASB janë logo të markave të IFAC, ose markave të regjistruara dhe markave të shërbimit të IFAC në SHBA dhe vendet e tjera.

Për informacione mbi të drejtën e autorit, markën tregtare dhe autorizimet, kontaktoni në permissions@ifac.org.

Publikim nga Stafi i Praktikave të Auditimit - Ngjarjet e Mëvonshme

“Ngjarjet e Mëvonshme në Mjedisin Aktual – Konsideratat e Auditimit për Ndikimin e COVID-19” nga “IAASB”, publikuar nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve (IFAC) në Maj 2020 në gjuhën angleze, është përkthyer në gjuhën shqipe nga Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA) në Qershor 2020, dhe është riprodhuar me lejen e IFAC. Teksti i aprovuar i të gjitha publikimeve të IFAC është ai i publikuar nga IFAC në gjuhën angleze. IFAC nuk mban përgjegjësi për saktësinë dhe plotësinë e përkthimit ose për veprimet që mund të rrjedhin prej tyre.

Teksti në gjuhën angleze “Ngjarjet e Mëvonshme në Mjedisin Aktual – Konsideratat e Auditimit për Ndikimin e COVID-19” © 2020 nga IFAC. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Teksti në gjuhën shqipe “Ngjarjet e Mëvonshme në Mjedisin Aktual – Konsideratat e Auditimit për Ndikimin e COVID-19” © [2020] nga IFAC. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Titulli original: “Subsequent Events in the Current Evolving Environment – Audit Consideration for the Impact of COVID-19”

Kontaktoni Permissions@ifac.org për marrjen e lejes për të riprodhuar, ruajtur, shpërndarë, apo për përdorime të tjera të ngjashme të këtij dokumenti.